DEKRET
Nr.7436, datë 1.12.1990

PËR KUNDËRVAJTJET NË BUJQËSI

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshillit të Ministrave;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Shkatërrimi ose dëmtimi i bimëve dhe i prodhimeve bujqësore e blegtorale, kulturave drufrutore e frutave të tyre, fidanëve, farës për mbjellje, kullotës, kashtës, barit, kallamit, kafshëve, shpendëve e koshereve të bletëve, vlefta e të cilave është mbi 20 lekë, përbën kundërvajtje administrative në bujqësi, kur:

a) kryhen nga pakujdesia dhe vlefta e dëmit të shkaktuar është nën 2000 lekë, ose edhe mbi këtë vleftë, kur nuk përbën vepër penale;

b) kryhen me dashje dhe vlefta e dëmit të shkaktuar është gjer në 500 lekë, ose është vendosur pushimi i çështjes për shkak të rëndësisë së vogël të veprës;

c) kundërvajtjet administrative përbëjnë edhe për përvetësimet e vogla në bujqësi me vleftë gjer në 300 lekë, kur kryhen për herë të parë.

Neni 2

Dëmi ose përvetësimi në bujqësi vërtetohet me procesverbal që mbahet, kryesisht ose mbi kallëzimin e të dëmtuarit ose të personave të tjerë, nga anëtarët e këshillit popullor, pjesëtarët e policisë popullore, anëtarët e kryesisë së kooperativës bujqësore, punonjësit e caktuar nga drejtoria e ndërmarrjes bujqësore ose rojtarët e ekonomive bujqësore, si dhe me dëshmitarë.

Procesverbali nënshkruhet nga përpiluesi dhe kundërvajtësi, kur ndodhet i pranishëm.

Neni 3

Çmuarja e dëmit të shkaktuar në bujqësi ose e pasurisë së përvetësuar bëhet nga çmuesit bujqësorë, që caktohen sipas rastit, nga këshilli populor i fshatit, i lagjes së qytetit, ose komiteti ekzektuvi i këshilit popullor të qytetit ku nuk ka lagje.

Në çmuarjen e dëmit ose të pasurisë së përvetësuar marrin pjesë 2, deri në 3 çmues.

Neni 4

Gjykimi i kundërvajtjeve administrative në bujqësi bëhet nga një komision me jomë pak se tre anëtarë, që caktohen, sipas rastit, nga dredjtori i ndërmarrjes bujqësore ose nga kryesia e kooperativës bujqësore.

Kundërvajtësi, veç detyrimit të zhdëmtimit të plotë të dëmit në bujqësi ose detyrimit oër kthimin e pasurisë së përvetësuar a të kundërvleftës së saj, dënohet me qortim shoqëror ose me gjobë nga 100, deri në 1000 lekë.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim bremda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij përkatësisht, te drejtori i ndërmarrjes bujqësore ose te kryetari i kooperativës bujqësore, akti i të cilëve është i formës së prerë.

Neni 5

Për shkatërrimet ose dëmtimet në bujqësi me vleftë gjer në 20 lekë detyrimi për zhdëmtim caktohet, sipas rastit, me urdhër të drejtorit të ndërmarrjes bujqësore, të kryetarit të kooperativës bujqësore ose të përgjegjësive të sektorëve.

Urdhri i tyre është i formës së prerë e përbën titull ekzekutiv.

Detyrimi për zhdëmtim caktohet si për punonjësit e vetë ndrmarrjes ose të kooperativës bujqësore, ashtu edhe për persona të tjerë.

Neni 6

Dekreti nr.4427, datë 23.9.1968 “Për mbrojtjen e bujqësisë”, shfuqizohet.

Neni 7

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI **SIHAT TOZAJ**	KRYETARI **RAMIZ ALIA**